



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

R A P O R T

PËR VETEVALUIMIN E FAKULTETIT FILOZOFIK

Tetovë, 31. 03. 2021

PËRMBAJTJA

| | |
|-----------------------------------------------------------------------------------|----|
| 1. QËLLIMI I PROCESIT TË VETEVAVULIMIT | 3 |
| 2. PËRSHKRIMI I FAKULTETIT | 3 |
| 2.1. Historiku | 3 |
| 2.2. Misioni | 4 |
| 2.3. Strategjia e zhvillimit | 4 |
| 3. STRUKTURA ORGANIZATIVE E FAKULTETIT FILOZOFIK | 5 |
| 3.1. Organogrami | 5 |
| 3.2. Programet studimore | 6 |
| 3.3. Vlerësimi i programit studimor aktual në nivel të programeve studimore | 6 |
| 4. VEPRIMTARIA MËSIMORE | 9 |
| 5. STRUKTURA E KUADRIT MËSIMOR-SHKENCOR..... | 13 |
| 6. STRUKTURA E STUDENTËVE | 17 |
| 6.1. Struktura e studentëve në ciklin e parë të studimeve | 17 |
| 6.2. Struktura e studentëve në ciklin e dytë të studimeve | 20 |
| 6.3. Struktura e studentëve në studimet e doktoraturës | 21 |
| 7. ANKETIMI I STUDENTËVE..... | 22 |
| 8. VEPRIMTARIA SHKENCORE DHE HULUMTUESE | 25 |
| 9. HAPËSIRAT DHE RESURSET MATERIALE | 27 |
| 10. SWOT ANALIZA | 28 |
| 11. KONKLUDIMI..... | 30 |

1. QËLLIMI I PROCESIT TË VETEVUALIMIT

Qëllimi kryesor i këtij raporti është që të bëhet evaluimi i procesit mësimor në Fakultetin Filozofik për vitet akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19, për të pasur një pasqyrë se si ka rrjedhur dhe si është zhvilluar procesi mësimor në këto vite akademike dhe në përgjithësi si është zhvilluar Fakulteti Filozofik. Përfundimet që do të dalin nga ky raport i evaluimit do të shërbejnë si bazë për zhvillimin dhe ngritjen e mëtutjeshme të kualitetit të procesit mësimor –shkencor.

Evaluimi është realizuar nga komisioni i brendshëm për vetevaluim i caktuar nga Këshilli i Fakulteti Filozofik në mbledhjen e mbajtur më 26.10.2020 dhe Vendimi për formimin e anëtarëve të komisionit me nr. 16-803/1, me datë; 26.10.2020.

Në procesin e evaluimit u përfshinë këto komponentë:

- Vlerësimi i programeve studimore, ku përfshihet themelimi, përshkrimi dhe zhvillimi i programeve studimore;
- Struktura e kuadrit mësimor;
- Struktura e studentëve deridiplomikë, master dhe të doktoraturës;
- Mënyra e realizimit të procesit mësimor;
- Anketimi i studentëve;
- Veprimtaria shkencore dhe pjesëmarrja në projekte e stafit të rregullt;
- Hapësirat dhe mjetet për realizimin e procesit mësimor.

Gjatë realizimit të procesit të evaluimit për përgatitje të këtij raportit, përveç anëtarëve të këtij komisioni, janë konsultuar edhe administrata dhe shërbimi studentor për marrjen e të dhënave të nevojshme.

2. PËRSHKRIMI I FAKULTETIT

2.1. Historiku

Fakulteti Filozofik është njëri nga gjashtë fakultetet themeluese të Universitetit të Tetovës. Në vitin e parë akademik në kuadër të Fakultetit Filozofik ka pasur dy programe studimore: Histori dhe Pedagogji, kurse nga viti akademik 1997/98 programi studimor Pedagogji funksiononte me tre drejtime: parashkollor, klasor dhe profesional. Nga viti akademik 2001/02 Fakulteti Filozofik u zgjerua me katër programe të reja studimore: Psikologji, Etnologji, Filozofi dhe Sociologji.

Me miratimin e Ligjit për themelimin e Universitetit të Tetovës, në vitin 2004, në kuadër të Universitetit të Tetovës u themeluan pesë fakultete, kurse Fakulteti Filozofik u emërua si Fakulteti i Shkencave Humane dhe Arteve, në kuadër të të cilit funksiononin shtatë programe studimore: Histori- Gjeografi, Filozofi- Sociologji, Pedagogji- Psikologji, Art muzikor, Art figurativ, Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, dhe Gjuhë dhe Letërsi Angleze.

Në vitin 2008 me miratimin e Ligjit të ri, Fakulteti Filozofik u riformatua me pesë programe studimore: Histori, Pedagogji, Filozofi, Psikologji dhe Sociologji. Në vitin akademik 2009/2010, Fakultetit Filozofik iu shtua programi studimor: Filologji Orientale, kurse në vitin akademik 2013 edhe programi studimor Edukim Special dhe Rehabilitim.

Në vitin akademik 2017/2018 nga Fakulteti Filozofik u shkëputën programet studimore Pedagogjia bashkë me ESR, nga të cilat u themelua Fakulteti Pedagogjik.

Të gjitha programet studimore në kuadër të Fakultetit Filozofik organizojnë studime katërvjeçare (240 ECTS) dhe studime njëvjeçare pasdiplomike (60 ECTS). Përveç programit studimor të Psikologjisë dhe Filozofisë, programet tjera studimore organizojnë edhe studime të doktoraturës.

2.2. Misioni

Programet studimore të Fakultetit Filozofik janë dizajnuar sipas principeve të sistemit të Bolonjës. Synohet që programet studimore t'i përshtaten dinamikës së reformave në sistemin arsimor në vend dhe përshtatjen kundrejt tendencave bashkëkohore në arsim.

Ky fakultet synon që studentët të arrijnë:

- konkurrim në tregun akademik evropian;
- profilizim përmes zhvillimit të kompetencave;
- programe të pranuar ndërkombëtarisht;
- mundësi lëvizjeje akademike.

2.3. Strategjia e zhvillimit

Fakultetit Filozofik në përputhje me misionin dhe vizionin e vet ka të përcaktuar një numër të madh të objektivave strategjike me synimin themelor që të ritë cilësinë e mësimdhënies përmes qasjeve inovative në fushën e arsimit të lartë, shkencës dhe teknologjisë. Strategjitë e zhvillimit e definojnë dhe orientojnë zhvillimin e këtij institucioni të lartë mësimor-shkencor, respektivisht i caktojnë mënyrat e arritjes, realizimit dhe

implementimit të qëllimeve të caktuara, njëherit duke i marrë parasysh të gjitha nevojat, mundësitë dhe specifikat e mjedisit në të cilin operon. Fakulteti Filozofik si komponentë përbërëse e Universitetit, paraqet një mjedis gjithëpërfshirës, dinamik dhe kompleks që ngërthen në vete potencialet më të rëndësishme shkencore, hulumtuese dhe kreative të një shoqërie dhe si i tillë tenton që përmes strategjisë së zhvillimit dhe qëllimeve të vendosura strategjike të përshtatura me standardet më të larta akademike të zhvillimit të reflektojë dhe ndikojë në realizimin e proceseve në të gjitha sferat e shoqërisë. Gjithashtu në kuadër të punës së tij shkencore përfshihen edhe projektet shkencore si dhe një sërë hulumtimesh aplikative përmes të cilave mundësohet zhvillimi i mendimit shkencor në vend dhe më gjerë.

3. STRUKTURA ORGANIZATIVE E FAKULTETIT

FILOZOFIK

3.1. Organogrami

Në Organogramin më poshtë është treguar mënyra e organizimit dhe funksionimit të Fakultetit Filozofik bazuar në Ligjin për arsim të lartë të RMV.




Figura 1. Organogrami i Fakultetit Filozofik

3.2. Programet studimore

Në kuadër të Fakultetit Filozofik gjatë periudhës tre vjeçare në vitet shkollore 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19, gjatë realizimit të procesit të evaluimit kanë funksionuar këto programe studimore:

1. Programi studimor Psikologji;
2. Programi studimor Histori;
3. Programi studimor Sociologji;
4. Programi studimor Filozofi;
5. Programi studimor Filologji Orientale.

Programi studimor Etnologji dhe antropologji edhe pse ishte i riakredituar nuk ka funksionuar.

3.3. Vlerësimi i programit studimor aktual në nivel të programeve studimore

Në vitin akademik 2018/2019 në drejtim të implementimit të sugjerimeve nga evaluatorët e jashtëm, nga shefat e programeve studimore/komisioneve përkatëse në bashkëpunim me Zyrën për menaxhimin me cilësinë dhe evaluim, është realizuar evaluimi i programeve aktuale studimore të Fakultetit Filozofik. Procesi i evaluimit ka përfshirë vlerësimin e secilës lëndë mësimore të përfshirë në program, për çdo indikator, respektivisht:

a. Lënda është në përputhshmëri me fushën e programit studimor të kategorizuar në bazë të kualifikimeve ndërkombëtare të Fraskatit;

b. Në bazë të syllabusit, kompetencat që i krijon lënda, janë jashtë kompetencave të përcaktuara me deskriptorët e përgjithshëm të programit;

c. Duke u bazuar në rrjedhshmërinë kronologjike të lëndëve paraprake, lënda është e vendosur në semestrin e duhur;

ç. Ngarkesa që ju bëhet studentëve (aktiviteti i studentëve, punime, projekte...) tejkalon kornizën e paraparë të ngarkesës me fondin e orëve dhe kreditë me të cilat është akredituar lënda;

d. Duke marrë parasysh zhvillimet e fundit shkencore të fushës së programit studimor, lënda ka nevojë për azhurnim;

dh. Bazuar në syllabus, lënda nxit zhvillimin e shkathtësive të cilat janë të aplikueshme në treg të punës;

e. Duke u bazuar në fushën e programit studimor, statusi aktual i lëndës (obligative, zgjedhore, opcionale), duhet të ndryshohet.

Në kuadër të programit studimor **Psikologji**, 29 lëndë obligative (rreth 83%) janë plotësisht në përputhshmëri me fushën e programit studimor sipas kualifikimit të Fraskatit, kurse 6 lëndë nuk i takojnë kategorizimit të programit studimor Psikologji. Prej gjithsej 40 lëndëve zgjedhore, sipas vlerësimit të përfaqësuesve të programit studimor, 10 prej tyre nuk janë të kategorizuara në fushën përkatëse sipas Fraskatit. Kompetencat e definuara në deskriptoret e përgjithshme të programit studimor studentët i përfitojnë nëpërmjet lëndëve, gjegjësisht definimit të qëllimit të lëndës në syllabus.

Tre lëndë obligative aspak nuk kanë të definuara qëllime kurse 51% e syllabuseve (lëndëve obligative) pjesërisht i kanë të definuara qëllime të cilat janë në përputhshmëri me deskriptorët e programit të Psikologjisë. Në lëndët zgjedhore, qëllimet e 15 prej tyre janë plotësisht jashtë kompetencave të parapara me deskriptorët e përgjithshëm dhe të veçantë të programit studimor. Në programin studimor të Psikologjisë katër lëndë obligative janë veçuar se aspak nuk janë të vendosura në semestrin e duhur sipas rrjedhshmërisë kronologjike. Aktivitetet e planifikuara me të cilat ngarkohen studentët me qëllim të përfitimit të kompetencave përkatëse në rreth 30% të lëndëve në programin studimor të Psikologjisë nuk janë në përputhshmëri me numrin e kredive dhe shpërndarjen e orëve sipas sasisë së kredisë së lëndës përkatëse.

Në kuadër të programit studimor **Histori**, 9 lëndë zgjedhore (rreth 27% prej lëndëve zgjedhore) aspak nuk janë në përputhshmëri me fushën e programit studimor sipas klasifikimit të Fraskatit, kurse 12 lëndë (rreth 33% prej lëndëve zgjedhore) pjesërisht i takojnë kategorizimit të programit studimor Histori. Prej gjithsej 33 lëndëve obligative, katër prej tyre nuk janë të klasifikuara në fushën e programit studimor përkatës.

Sipas analizës së lëndëve të programit studimor të Historisë nga komisioni i fakultetit, të gjitha lëndët gjatë definimit të qëllimeve arrijnë të zhvillojnë kompetencat e parapara me deskriptorët e përgjithshme dhe specifik të programit studimor Histori si dhe shumica e aktivitetet e planifikuara janë në përputhshmëri të plotë me numrin e kredive që është e ngarkuar lënda.

Analiza e programit studimor aktual **Sociologji** tregon se 31% (ose 11 lëndë) e lëndëve zgjedhore pjesërisht i përkasin fushës së programit studimor të Sociologjisë sipas kualifikimeve nacionale të Fraskatit, kurse katër të tjera aspak nuk janë pjesë e fushës shkencore të lartpërmendur. Gjashtë prej lëndëve obligative janë pjesërisht kurse katër lëndë aspak nuk i përkasin fushës së Sociologjisë sipas të njëjtit klasifikim.

Kompetencat të cilat i krijon lënda në syllabus, relativisht janë në përputhshmëri me deskriptorët e programit Sociologji. Konkretisht, pesë lëndë ose 15% e lëndëve obligative pjesërisht ose aspak nuk kanë të definuara qëllime në përputhshmëri me deskriptorët e programit.

Përputhshmëria mes qëllimeve të lëndëve dhe deskriptorëve mungon pjesërisht (13 lëndë) plotësisht (4 lëndë) në rreth 24% të lëndëve zgjedhore. Aktivitetet e planifikuara me të cilët ngarkohen studentët me qëllim të përfitimit të kompetencave përkatëse në 39% të lëndëve nuk janë në përputhshmëri me numrin e kredive dhe shpërndarjen e orëve sipas sasisë së kredisë së lëndës përkatëse. Konkretisht, prej 72 lëndëve obligative dhe zgjedhore prej të cilave është strukturuar programi studimor Sociologji, 15 prej lëndëve zgjedhore si dhe 13 lëndë obligative nuk kanë shpërndarë orët e aktiviteteve të cilat duhet të realizojnë studentët konform numrit të kredive të lëndës.

Struktura e programit studimor **Filozofi** në masë të madhe është në përputhshmëri me fushën shkencore të Filozofisë sipas klasifikimit të Fraskatit. Megjithatë, kur në veçanti analizohen lëndët obligative dhe zgjedhore, vihet në pah se thuajse gjysma e lëndëve zgjedhore janë pjesërisht ose aspak nuk i takojnë kategorizimit të Filozofisë sipas Fraskatit. Në këtë drejtim është i nevojshëm rishqyrtimi i lëndëve zgjedhore. Rreth 89% e lëndëve obligative zhvillojnë kompetenca që korrespondojnë me deskriptorët e programit studimor. Rreth gjysma e lëndëve zgjedhore kanë pjesërisht ose aspak nuk kanë të definuara kompetenca (ose aspak nuk janë në përputhshmëri me deskriptorët). Rreth 30% e lëndëve nuk kanë shpërndarje të aktiviteteve të cilat i realizojnë studentët në përputhje me numrin e kredive dhe shpërndarjen e orëve sipas sasisë së kredisë së lëndës përkatëse.

4. VEPRIMTARIA MËSIMORE

Në pesë programe studimore të Fakultetit Filozofik, studimet zgjasin 4 vjet (tetë semestra) dhe studentët gjithsej akumulojnë 240 (ECTS) kredi.

Programi studimor: Psikologji

Programi studimor i Psikologjisë është një nga drejtimet e para të Universitetit të Tetovës që nisi punën në vitin akademik 2001/2002, në kuadër të Fakultetit Filozofik. Programi studimor i Psikologjisë ka të akredituara dy drejtime: arsimor dhe profesional. Studenti që diplomon merr thirrjen *Psikolog i diplomuar*.

Programi studimor: Histori

Programi studimor i Historisë është themeluar në vitin akademik 1994/1995, në kuadër të Fakultetit Filozofik. Programi studimor i Historisë ka të akredituara dy drejtime: arsimor dhe profesional. Studenti që diplomon në drejtimin arsimor merr thirrjen *Profesor i diplomuar i Historisë*, ndërsa ai që diplomon në drejtimin profesional thirrjen *Historian i diplomuar*. Studimet zhvillohen vetëm në drejtimin arsimor.

Programi studimor: Sociologji

Programi studimor i Sociologjisë është themeluar në vitin 2001/2002 në kuadër të Fakultetit Filozofik. Studentët të cilët ndjekin këtë program studimor marrin titullin *Profesor i diplomuar i Sociologjisë*.

Programi studimor: Filozofi

Programi studimor i Filozofisë nisi punën në vitin akademik 2001/2002, në kuadër të Fakultetit Filozofik. Katedra e Filozofisë ka të akredituar drejtimin arsimor. Studenti që diplomon merr thirrjen *Profesor i diplomuar i Filozofisë*.

Programi studimor: Filologji orientale

Programi studimor Filologji orientale nisi punën në vitin akademik 2008/2009, në kuadër të Fakultetit Filozofik në Universitetin e Tetovës. Programi studimor i Filologjisë

orientale ka të akredituara dy drejtime: Gjuhë dhe Letërsi Arabe dhe Gjuhë dhe Letërsi Turke. Studenti që diplomon merr thirrjen *Profesor i diplomuar i gjuhës dhe letërsisë arabe/turke*.

Të dhëna për akreditimin e fundit të programeve studimore- studimet e ciklit parë

- Vendim për akreditimin e programeve studimore të ciklit të parë në Fakultetin Filozofik në Universitetin e Tetovës, nr. **12-256/1-1** te datës **16.04.2013**.

Histori

- *Drejtimi arsimor*
- *Drejtimi profesional*

Psikologji

- *Drejtimi profesional*

Filozofi

- *Drejtimi arsimor*

Sociologji

- *Drejtimi arsimor*

Filologji orientale

- *Gjuhë dhe Letërsi Arabe*
- *Gjuhë dhe Letërsi Turke*
-

Tabela 1. Programet e ciklit të parë dhe kualifikimet

| PROGRAMI | DREJTIMI | S | ECTS | KUALIFIKIMI |
|---------------------|-------------------|----------|-------------|-------------------------------------|
| HISTORI | Arsimor | 8 | 240 | Profesor i diplomuar i historisë |
| | Profesional | 8 | 240 | Historian i diplomuar |
| PSIKOLOGJI | Profesional | 8 | 240 | Psikolog i diplomuar |
| SOCIOLOGJI | Arsimor | 8 | 240 | Profesor i diplomuar i sociologjisë |
| FILOZOFI | Arsimor | 8 | 240 | Profesor i diplomuar i filozofisë |
| FILOLOGJI ORIENTALE | Gjuhë dhe letërsi | 8 | 240 | Profesor i diplomuar i Gjuhës dhe |

| | | | | |
|--|----------------------------|---|-----|------------------------------------------------------|
| | arabe | | | Letërsisë Arabe |
| | Gjuhë dhe letërsi turke | 8 | 240 | Profesor i diplomuar i Gjuhës dhe Letërsisë Turke |

Të dhëna për akreditimin e fundit të programeve studimore- studimet e ciklit dytë (master)

- Vendimi për akreditimin e programit studimor të ciklit të dytë, studime njëvjeçare në Fakultetin Filozofik në Universitetin e Tetovës, Filologji orientale- drejtimi: Gjuhë dhe Letërsi Turke me nr. 12-197/2, Filologji orientale- drejtimi: Gjuhë dhe Letërsi Arabe me nr. 12-197/3, të dy vendimet te datës 24.03.2014.
- Vendimi për akreditimin e programit studimor të ciklit të dytë, studime njëvjeçare në Fakultetin Filozofik në Universitetin e Tetovës, Histori- drejtimi: Historia e kohës bashkëkohore me nr. 12-117/7, Histori- drejtimi: Historia e kohës së re me nr. 12-117/8, Histori- drejtimi: Historia e mesjetës, me nr. 12-117/9, të gjithë te datës 15.12.2014.
- Vendimi për akreditimin e programit studimor të ciklit të dytë, studime njëvjeçare në Fakultetin Filozofik në Universitetin e Tetovës, Sociologji- drejtimi: Studime kulturologjike me nr. 12-117/6, Sociologji- drejtimi: Shoqëria dhe ndryshimet globale me nr. 12-117/21, të dy vendimet te datës 15.12.2014.
- Vendimi për akreditimin e programit studimor Filozofi-drejtimi: Filozofi bashkëkohore të ciklit të dytë, studime njëvjeçare në Fakultetin Filozofik në Universitetin e Tetovës, nr. 12-117/113 te datës 15.12.2014.
- Vendimi për akreditimin e programit studimor të ciklit të dytë, studime njëvjeçare në Fakultetin Filozofik në Universitetin e Tetovës, Psikologji- drejtimi: Psikologji pedagogjike me nr. 12-163/7, Psikologji- drejtimi: Psikologji organizative me nr. 12-163/8, Psikologji- drejtimi: Psikologji klinike me nr. 12-163/9, të gjithë te datës 18.05.2018.

Tabela 2. Programet e ciklit të dytë dhe kualifikimet

| PROGRAMI | DREJTIMI | S | ECTS | KUALIFIKIMI |
|---------------------|-----------------------------------------|----------|-------------|-----------------------------------------------------------------------------|
| HISTORI | Historia e mesjetës | 2 | 60 | Magjistër i shkencave të historisë-drejtimi: historia e mesjetës |
| | Historia e kohës së re | 2 | 60 | Magjistër i shkencave të historisë-drejtimi: historia e kohës së re |
| | Historia bashkëkohore | 2 | 60 | Magjistër i shkencave të historisë-drejtimi: historia bashkëkohore |
| PSIKOLOGJI | Pedagogjike | 2 | 60 | Magjistër i psikologjisë – Psikologjia pedagogjike |
| | Organizative | 2 | 60 | Magjistër i psikologjisë – Psikologjia organizative |
| | Klinike | 2 | 60 | Magjistër i psikologjisë – Psikologjia klinike |
| SOCIOLOGJI | Shoqëria dhe problemet globale | 2 | 60 | Magjistër i shkencave sociologjike-drejtimi: shoqëria dhe problemet globale |
| | Studime kulturologjike | 2 | 60 | Magjistër i shkencave sociologjike-drejtimi: studime kulturologjike |
| FILOZOFI | Filozofi bashkëkohore | 2 | 60 | Magjistër i shkencave filozofike nga lëmi i filozofisë bashkëkohore |
| | Filozofi bashkëkohore në gjuhën angleze | 2 | 60 | Magjistër i shkencave filozofike nga lëmia e filozofisë bashkëkohore |
| FILOLOGJI ORIENTALE | Gjuhë dhe Letërsi Turke | 2 | 60 | Magjistër i Filologjisë orientale – Gjuhë dhe Letërsi Turke |
| | Gjuhë dhe Letërsi Arabe | 2 | 60 | Magjistër i Filologjisë orientale – Gjuhë dhe Letërsi Arabe |

Të dhëna për akreditimin e fundit të programeve studimore- studimet e ciklit tretë (doktoraturë)

- Vendimi për akreditimin e programit studimor të ciklit të tretë, studime trevjeçare doktorale në Fakultetin Filozofik në Universitetin e Tetovës, Histori- drejtimi: Historia e popullit shqiptar- koha e re me nr. 12-253/2, Histori- drejtimi: Historia e popullit shqiptar- koha bashkëkohore me nr. 12-253/3, te dy vendimet te datës 08.04.2015.

- Vendimi për akreditimin e programit studimor të ciklit të tretë, studime trevjeçare doktorale në Fakultetin Filozofik në Universitetin e Tetovës, Shkenca për gjuhëndrejtimi: Filologji orientale nr. 1409-208/2 te datës 29.11.2017.
- Vendimi për akreditimin e programit studimor të ciklit të tretë, studime trevjeçare doktorale në Fakultetin Filozofik në Universitetin e Tetovës, Sociologji- drejtimi: Socio-politik me nr. 1409-205/5, Sociologji- drejtimi: Socio-kulturor me nr. 1409-205/6, te datës 19.06.2018.

Tabela 3. Programet e ciklit të tretë

| PROGRAMI | DREJTIMI | S | ECTS |
|---------------------|-------------------------------------------------|----------|-------------|
| HISTORI | Historia e popullit shqiptar- Koha e re | 6 | 180 |
| | Historia e popullit shqiptar- Koha bashkëkohore | 6 | 180 |
| FILOLOGJI ORIENTALE | Shkenca për gjuhën | 6 | 180 |
| SOCIOLOGJI | Socio-politik | 6 | 180 |
| | Socio- kulturor | 6 | 180 |

5. STRUKTURA E KUADRIT MËSIMOR-SHKENCOR

Në vitin akademik 2016/2017 në Fakultetin Filozofik në procesin e mësimdhënies janë angazhuar gjithsej 25 mësimdhënës me status të rregullt, edhe atë: 8 profesorë ordinarë, 11 profesorë inordinarë dhe 6 docentë. Struktura gjinore e profesorëve është 20 meshkuj dhe 5 femra.

Me qëllim të realizimit të suksesshëm të procesit mësimor në këtë vit akademik, Fakulteti Filozofik ka angazhuar staf akademik me kontratë me gjithsej 16 mësimdhënës, prej tyre 4 profesorë ordinarë dhe 9 docentë dhe 3 ligjërues (dr.sc). Struktura gjinore e mësimdhënësve të angazhuar është e përbërë prej 14 meshkuj dhe 2 femra.

Në vitin akademik 2016/17, në Fakultetin Filozofik kanë qenë të angazhuar 10 bashkëpunëtorë të rregullt, të gjithë të gjinisë femërore, ndërsa me kontratë janë angazhuar 16 bashkëpunëtorë prej tyre 7 meshkuj dhe 9 femra.

Tabela 4. Struktura e mësimdhënësve sipas titujve shkencorë, akademikë dhe gjinisë në vitin akademik 2016-17

| MËSIMDHËNËS | | | | | | | |
|--------------------|-----------|----------|-----------|--------------------|-----------|----------|-----------------|
| Të rregullt | Meshkuj | Femra | Gjithsej | Me kontratë | Meshkuj | Femra | Gjithsej |
| Ordinar | 7 | 1 | 8 | Ordinar | 4 | / | 4 |
| Inordinar | 9 | 2 | 11 | Inordinar | / | / | / |
| Docent | 4 | 2 | 6 | Docent | 9 | / | 9 |
| | | | | Ligjërues(dr.sc) | 1 | 2 | 3 |
| Gjithsej | 20 | 5 | 25 | | 14 | 2 | 16 |

Tabela 5. Struktura e bashkëpunëtorëve sipas titujve shkencorë, akademikë dhe gjinisë në vitin akademik 2016-17

| BASHKËPUNËTORË | | | | | | | |
|-----------------------|----------|-----------|-----------|--------------------|----------|----------|-----------------|
| Të rregullt | Meshkuj | Femra | Gjithsej | Me kontratë | Meshkuj | Femra | Gjithsej |
| Asistent | / | 9 | 9 | Asistent | 6 | 6 | 12 |
| Asistent i ri | / | 1 | 1 | Asistent i ri | / | / | / |
| | | | | Demonstratorë | 1 | 3 | 4 |
| Gjithsej | / | 10 | 10 | | 7 | 9 | 16 |

Në vitin akademik 2017/2018 në Fakultetin Filozofik në procesin e mësimdhënies janë angazhuar gjithsej 27 profesorë me status të rregullt, edhe atë: 9 profesorë ordinarë, 12 profesorë inordinarë dhe 6 docentë. Struktura gjinore e profesorëve është 21 meshkuj dhe 6 femra.

Me qëllim të realizimit të suksesshëm të procesit mësimor në këtë vit akademik, Fakulteti Filozofik ka angazhuar staf akademik part-time gjithsej 14 mësimdhënës, prej tyre 3 profesorë ordinarë, 1 profesor inordinar dhe 7 docentë dhe 3 ligjërues (dr.sc).

Struktura gjinore e mësimdhënësve të angazhuar është e përbërë nga 13 meshkuj dhe 1 femër.

Në vitin akademik 2017/18, në Fakultetin Filozofik kanë qenë të angazhuar 5 bashkëpunëtorë të rregullt, të gjinisë femërore, ndërsa me kontratë janë angazhuar 19

bashkëpunëtorë prej tyre 9 meshkuj dhe 10 femra.

Në vitin akademik 2017/2018 për dallim nga viti paraprak, kemi rritje të numrit të mësimitdhënësve me thirrje mësimore- shkencore, edhe atë nga një profesor inordinar dhe docent, si pasojë e zgjedhjes-rizgjedhjes. Po ashtu kemi rritje edhe të numrit të asistentëve nga 1 në 4. Kemi edhe rritjen e numrit të femrave nga 5 në 6 te mësimitdhënësit dhe nga 1 në 4 te asistentët.

Në stafin e angazhuara part-time nuk ka shumë ndryshime. Më pak mësimitdhënës të angazhuar dhe rritje të numrit të asistentëve dhe demonstratorëve.

Tabela 6. Struktura e mësimitdhënësve sipas titujve shkencorë, akademikë dhe gjinisë në vitin akademik 2017-18

| MËSIMDHËNËS | | | | | | | |
|--------------------|-----------|----------|-----------|--------------------|-----------|----------|-----------------|
| Të rregullt | Meshkuj | Femra | Gjithsej | Me kontratë | Meshkuj | Femra | Gjithsej |
| Ordinar | 8 | 1 | 9 | Ordinar | 3 | / | 3 |
| Inordinar | 10 | 2 | 12 | Inordinar | 1 | / | 1 |
| Docent | 3 | 3 | 6 | Docent | 7 | / | 7 |
| | | | | Ligjërues (dr.sc) | 2 | 1 | 2 |
| Gjithsej | 21 | 6 | 27 | Gjithsej | 13 | 1 | 14 |

Tabela 7. Struktura e bashkëpunëtorëve sipas titujve shkencorë, akademikë dhe gjinisë në vitin akademik 2017-18

| BASHKËPUNËTORË | | | | | | | |
|-----------------------|----------|----------|----------|--------------------|----------|-----------|-----------------|
| Të rregullt | Meshkuj | Femra | Gjithsej | Me kontratë | Meshkuj | Femra | Gjithsej |
| Asistent | / | 4 | 4 | Asistent | 7 | 7 | 14 |
| Asistent i ri | / | 1 | 1 | Asistent i ri | / | / | / |
| | / | / | / | Demonstratorë | 2 | 3 | 5 |
| Gjithsej | / | 5 | 5 | Gjithsej | 9 | 10 | 19 |

Në vitin akademik 2018/2019 në Fakultetin Filozofik në procesin e mësimitdhënies

janë angazhuar gjithsej 28 profesorë me status të rregullt edhe atë 10 profesorë ordinarë, 10 profesor inordinarë dhe 8 docentë. Struktura gjinore e profesorëve është 21 meshkuj dhe 7 femra.

Me qëllim të realizimit të suksesshëm të procesit mësimor në këtë vit akademik, Fakulteti Filozofik ka angazhuar staf akademik part-time gjithsej 11 mësimdhënës, prej tyre 4 profesorë ordinarë, 1 profesor inordinar, 3 docentë dhe 3 ligjërues (dr.sc).

Struktura gjinore e mësimdhënësve të angazhuar është e përbërë nga 9 meshkuj dhe 2 femra. Në vitin akademik 2018/19, në Fakultetin Filozofik kanë qenë të angazhuar 5 bashkëpunëtorë të rregullt, 2 meshkuj dhe 3 femra, ndërsa me kontratë janë angazhuar 25 bashkëpunëtorë prej tyre 12 meshkuj dhe 13 femra.

Në vitin akademik 2018/2019 për dallim nga viti paraparak kemi rritje të numrit të stafit si rrjedhojë e angazhimit të dy mësimdhënësve dhe 2 asistentëve në programin studimor Filologji orientale. Avancimin e tre mësimdhënësve në thirrje mësimor-shkencore, dhe largimin e dy mësimdhënësve nga stafi i rregullt. Rritje të numrit të mësimdhënësve femra.

Në stafin e angazhuar part-time nuk ka shumë ndryshime, krahas një uljeje të vogël të numrit të mësimdhënësve dhe asistentëve të angazhuar.

Tabela 8 . Struktura e mësimdhënësve sipas titujve shkencorë, akademikë dhe gjinisë në vitin akademik 2018-19

| MËSIMDHËNËS | | | | | | | |
|--------------------|-----------|----------|-----------|--------------------|----------|----------|-----------------|
| Të rregullt | Meshkuj | Femra | Gjithsej | Me kontratë | Meshkuj | Femra | Gjithsej |
| Ordinar | 8 | 2 | 10 | Ordinar | 4 | / | 4 |
| Inordinar | 9 | 1 | 10 | Inordinar | 1 | / | 1 |
| Docent | 4 | 4 | 8 | Docent | 3 | / | 3 |
| | | | | Ligjërues (dr.sc) | 1 | 2 | 3 |
| Gjithsej | 21 | 7 | 28 | Gjithsej | 9 | 2 | 11 |

Tabela 9 . Struktura e bashkëpunëtorëve sipas titujve shkencorë, akademikë dhe gjinisë në vitin akademik 2018-19

| BASHKËPUNËTORË | | | | | | | |
|-----------------------|----------|----------|----------|--------------------|-----------|-----------|-----------------|
| Të rregullt | Meshkuj | Femra | Gjithsej | Me kontratë | Meshkuj | Femra | Gjithsej |
| Asistent | 2 | 2 | 4 | Asistent | 9 | 8 | 17 |
| Asistent i ri | / | 1 | 1 | Asistent i ri | / | / | / |
| | | | | Demonstratorë | 3 | 5 | 8 |
| Gjithsej | 2 | 3 | 5 | Gjithsej | 12 | 13 | 25 |

6. STRUKTURA E STUDENTËVE

6.1. Struktura e studentëve në ciklin e parë të studimeve

Në vitin akademik 2016/2017 në studimet deridiplomike numri i përgjithshëm i studentëve që kanë ndjekur studimet në Fakultetin Filozofik është 688 studentë, edhe atë: 332 në Psikologji, 129 në Histori, 126 në Sociologji, 80 në Filologji orientale dhe 21 në Filozofi.

Në vitin akademik 2017/2018 në studimet deridiplomike numri i përgjithshëm i studentëve që kanë ndjekur studimet në Fakultetin Filozofik është 632 studentë, edhe atë: 283 në Psikologji, 136 në Sociologji, 93 në Histori, 81 në Filologji orientale dhe 39 në Filozofi.

Në vitin akademik 2018/2019 në studimet deridiplomike numri i përgjithshëm i studentëve që kanë ndjekur studimet në Fakultetin Filozofik është 688 studentë, edhe atë: 332 në Psikologji, 105 në Sociologji, 77 në Filologji orientale, 69 në Histori dhe 28 në Filozofi.

Rënia e numrit të përgjithshëm është si rezultat i diplomimit të studentëve dhe regjistrimit çdo vit e më pak për herë të parë. Programi studimor Histori ka rënien më të madhe të numrit të përgjithshëm rreth 50% (nga 129 në vitin 2016/2017 në 69 në vitin 2018/2019).

Tabela 10. Numri i studentëve aktiv sipas programeve studimore në vitet akademike 2016/17; 2017/18 dhe 2018/19

| PROGRAMI STUDIMOR | 2016/17 | 2017/18 | 2018/19 |
|--------------------------|----------------|----------------|----------------|
| Psikologji | 332 | 283 | 248 |
| Sociologji | 126 | 136 | 105 |
| Histori | 129 | 93 | 69 |
| Filologji orientale | 80 | 81 | 77 |
| Filozofi | 21 | 39 | 28 |
| Gjithsej | 688 | 632 | 527 |

Në vitin akademik 2016/2017 në studimet deridiplomike në Fakultetin Filozofik për herë të parë janë regjistruar 130 studentë, edhe atë: 56 në Psikologji, 31 në Histori, 25 në Sociologji, 12 në Filologji orientale dhe 6 në Filozofi.

Në vitin akademik 2017/2018 në studimet deridiplomike në Fakultetin Filozofik për herë të parë janë regjistruar 130 studentë, edhe atë: 52 në Psikologji, 32 në Sociologji, 26 në Filologji orientale, 14 në Histori, dhe 6 në Filozofi.

Në vitin akademik 2018/2019 në studimet deridiplomike në Fakultetin Filozofik për herë të parë janë regjistruar 74 studentë, edhe atë: 31 në Psikologji, 17 në Filologji orientale, 13 në Sociologji, 12 në Histori dhe vetëm 1 në Filozofi.

Programi studimor Histori ka rënie të numrit të përgjithshëm gjatë dy viteve radhazi (2017/18 dhe 2018/19), Psikologjia, Sociologjia dhe Filologjia orientale kanë rënie të ndjeshme në vitin 2018/19, kurse Filozofia nga viti 2018/2019 është detyruar të pauzojë.

Rënia e numrit të studentëve në vitin akademik 2018/2019 është shqetësuese. Arsyet janë të shumta dhe shumica e tyre janë faktorë të jashtëm si migrimi i të rinjve, mundësitë e vogla në tregun e punës, mungesa e stabilitetit politik, kriza ekonomike, etj.

Tabela 11. Struktura e studentëve sipas programeve studimore në vitet akademike 2016/17; 2017/18 dhe 2018/19 të regjistruar për herë të parë

| PROGRAMI STUDIMOR | 2016/17 | 2017/18 | 2018/19 |
|--------------------------|----------------|----------------|----------------|
| Psikologji | 56 | 52 | 31 |
| Sociologji | 25 | 32 | 13 |
| Histori | 31 | 14 | 12 |

| | | | |
|---------------------|------------|------------|-----------|
| Filologji orientale | 12 | 26 | 17 |
| Filozofi | 6 | 6 | 1 |
| Gjithsej | 130 | 130 | 74 |

Në vitin akademik 2016/2017 në studimet deridiplomike në Fakultetin Filozofik janë transferuar 68 studentë, shumica prej të cilëve rreth 80% në Psikologji (56 nga 68), 5 në Sociologji, 4 në Histori, 2 në Filologji orientale dhe 1 në Filozofi. Nga 68 studentët e transferuar 40 kanë bërë transfer të brendshëm kurse 28 të jashtëm.

Në vitin akademik 2017/2018 në studimet deridiplomike në Fakultetin Filozofik janë transferuar 30 studentë, gjysma prej të cilëve në Psikologji, 5 në Sociologji, 4 në Histori, 3 në Filologji orientale dhe 1 në Filozofi. Nga 51 studentët e transferuar 26 kanë bërë transfer të brendshëm kurse 25 të jashtëm.

Në vitin akademik 2018/2019 në studimet deridiplomike në Fakultetin Filozofik janë transferuar 22 studentë, shumica prej të cilëve në Psikologji (12 nga 22), 5 në Sociologji, 4 në Histori dhe 1 në Filologji orientale. Nga 22 studentët e transferuar 12 kanë bërë transfer të brendshëm kurse 10 të jashtëm.

Si përfundim, numri i përgjithshëm i transfereve gjatë këtyre tre viteve ka qenë 141, nga të cilët 78 të brendshëm dhe 63 të jashtëm. Sipas programeve studimore më shumë studentë janë transferuar në Psikologji gjithsej 91 studentë (50 të brendshëm dhe 41 të jashtëm), 29 në Sociologji (18 të brendshëm dhe 11 të jashtëm), 9 në Histori (7 të brendshëm dhe 2 të jashtëm), 6 në Filologji orientale (të gjithë të jashtëm), 6 Filozofi (3 të brendshëm dhe 3 të jashtëm).

Tabela 12. Struktura e studentëve sipas programeve studimore në vitet akademike 2016/17; 2017/18 dhe 2018/19 të transferuar

| PROGRAMI STUDIMOR | 2016/17 | 2017/18 | 2018/19 |
|--------------------------|----------------|----------------|----------------|
| Psikologji | 56 (23) | 23 (13) | 12 (5) |
| Sociologji | 5 (2) | 19 (6) | 5 (3) |
| Histori | 4 (1) | 1 | 4 (1) |
| Filologji orientale | 2 (2) | 3 (3) | 1 (1) |

| | | | |
|-----------------|-----------|-----------|-----------|
| Filozofi | 5 (3) | 3 | / |
| Gjithsej | 46 | 30 | 22 |

Shënim: Numrat brenda kllapave janë studentët e transferuar nga jashtë

6.2. Struktura e studentëve në ciklin e dytë të studimeve

Në vitin akademik 2016/2017 në studime të shkallës së dytë (master) janë regjistruar gjithsej 25 studentë, edhe atë: 12 në Psikologji, 8 në Filologji orientale, nga 2 në Histori dhe Filozofi dhe 1 në Sociologji. Struktura gjinore e studentëve të regjistruar është 7 meshkuj dhe 18 femra. Në programin studimor Psikologji nga 12 studentët e regjistruar 10 janë femra, 7 nga të cilat shtetase të huaja, përkatësisht nga Republika e Kosovës. Shumica e studentëve të regjistruar femra janë edhe në programin studimor Filologji orientale, 5 nga gjithsej 8 studentë.

Në vitin akademik 2017/2018 në studime të shkallës së dytë (master) janë regjistruar gjithsej 32 studentë, edhe atë: 18 në Psikologji, 7 në Filologji orientale, 3 në Histori, 3 në Sociologji dhe 1 në Filozofi. Struktura gjinore e studentëve të regjistruar është 10 meshkuj dhe 22 femra. Në programin studimor Psikologji nga 18 studentët e regjistruar 16 janë femra, 10 nga të cilat shtetase të huaja, përkatësisht nga Republika e Kosovës.

Në vitin akademik 2018/2019 në studime të shkallës së dytë (master) janë regjistruar gjithsej 36 studentë, edhe atë: 16 në Psikologji, 9 në Filologji orientale, 6 në Sociologji, 4 në Histori dhe 1 në Filozofi. Struktura gjinore e studentëve të regjistruar është 13 meshkuj dhe 23 femra. Në programin studimor Psikologji nga 12 studentët e regjistruar 13 janë femra, 7 nga të cilat shtetas të huaja, përkatësisht nga Republika e Kosovës. Shumica e studentëve të regjistruar janë femra edhe në programet studimore Sociologji, 5 nga gjithsej 6 studentë.

Si përfundim, gjatë tre viteve akademike të lartpërmendura, në Fakultetin Filozofik në studimet e shkallës së dytë (master) gjithsej janë regjistruar 93 studentë, gjysma prej tyre në programin studimor Psikologji (46 nga gjithsej 93), 22 në Filologji orientale, 10 në Sociologji, 9 në Histori dhe 4 në Filozofi. Sipas strukturës gjinore 2/3 e studentëve të regjistruar janë femra, apo 63 nga gjithsej 93, shumica prej të cilëve në programin studimor Psikologji, 39 nga 63 studentët femra.

Për dallim nga studimet deridiplomike në studimet e shkallës së dytë (master) ka rritje të studentëve të regjistruar në Fakultetin Filozofik, kjo si rezultat i ofertës së pasur akademike

që ofron Fakulteti Filozofik me 5 programe studimore dhe 11 drejtime, përkushtimit të udhëheqësisë dhe mësimdhënësve si dhe interesimit të studentëve që janë shtetas të huaj, në radhë të parë nga Republika e Kosovës.

Tabela 13. Struktura e studentëve sipas programeve studimore në vitet akademike 2016/17; 2017/18 dhe 2018/19 të regjistruar për herë të parë

| PROGRAMI STUDIMOR | 2016/17 | 2017/18 | 2018/19 |
|--------------------------|----------------|----------------|----------------|
| Psikologji | 12 | 18 | 16 |
| Sociologji | 1 | 3 | 6 |
| Histori | 2 | 3 | 4 |
| Filologji orientale | 8 | 7 | 9 |
| Filozofi | 2 | 1 | 1 |
| Gjithsej | 25 | 32 | 36 |

6.3. Struktura e studentëve në studimet e doktoraturës

Nga viti akademik 2016/2017, në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Tetovës zhvillohen studime të ciklit të tretë, studime trevjeçare doktorale. Fillimisht studentët janë regjistruar në programin studimor Histori, në dy drejtime: Historia e popullit shqiptar- koha e re, dhe Historia e popullit shqiptar- koha bashkëkohore. Në të dy drejtimet janë regjistruar 6 studentë dhe kanë qenë të akredituar 4 mentorë.

Në vitin akademik 2018/2019, në kuadër të studimet e shkallës së tretë (doktoraturës) kanë filluar që të zhvillohen edhe në dy programe studimore, në Sociologji dhe Filologji orientale. Në programin studimor Sociologji, në drejtimin Socio-politik, dhe Socio-kulturor gjithsej janë regjistruar 4 studentë dhe kanë qenë të akredituar 2 mentorë. Në programin studimor Filologji orientale, në drejtimin Shkenca për gjuhën, janë regjistruar gjithsej 6 studentë dhe kanë qenë të akredituar 2 mentorë.

Sipas strukturës gjinore, nga 16 studentët e regjistruar, 12 janë meshkuj dhe 4 femra. Shumica e studentëve të regjistruar (11 nga 16) janë shtetas të huaj, kryesisht nga Republika e Kosovës.

Tabela 14. Struktura e studentëve të doktoraturës sipas programeve studimore

| PROGRAMI STUDIMOR | 2016/17 | 2017/18 | 2018/19 |
|--------------------------|----------------|----------------|----------------|
| Sociologji | / | / | 4 |
| Histori | 6 | / | / |
| Filologji orientale | / | / | 6 |
| Gjithsej | 6 | / | 10 |

7. ANKETIMI I STUDENTËVE

Evaluimi i orës mësimore është realizuar nëpërmjet vlerësimit të disa komponentëve edhe atë: vlerësimin e saktësisë së procesit të mësimdhënies (fillimin dhe mbarimin e orës), vlerësimin e realizimit të ligjëratave, vlerësimin e përmbajtjes së ligjëratave, si dhe menaxhimin e orës mësimore përfshirë dhe interaksionin joverbal të mësimdhënësit.

Evaluimi orëve mësimore si pjesë e anketimit të studentëve gjatë vitit 2016 ka përfshirë 380 studentë. Rreth 88% e studentëve në Fakultetin Filozofik vlerësojnë se ligjëratat fillojnë saktë sipas orarit, kurse rreth 78% se ligjëratat mbarojnë në kohën e paraparë sipas orarit të shpallur. Përqindja më e madhe e studentëve që deklarojnë se ligjëratat fillojnë dhe mbarojnë sipas orarit të paraparë janë në programin studimor Histori (94%) kurse në programin studimor Sociologji (68%). Rreth (63%) e studentëve në Fakultetin Filozofik deklarojnë se gjatë ligjëratës nuk kanë bërë pauzë, si dhe rreth (31%) kanë bërë pauzë 10 deri 15 minuta.

Sipas programeve studimore në Histori diku rreth (54%) deklarojnë se gjatë ligjëratave bëjnë pauzë 10 deri 15 minuta. Për realizim të orëve gjatë ligjëratave në Fakultetin Filozofik përdoren mjete të ndryshme për prezantim. Studentët deklarojnë rreth (23%) se gjatë ligjëratës mësimdhënësit kanë përdorur Power Point prezantime, kurse rreth 31% e studentëve deklarojnë se përdoret tekst në tabelë, dhe diku rreth (17%) deklarojnë se gjatë ligjëritimit mësimdhënësit nuk përdorin asnjë mjet për të realizuar ligjëratën. Përqindja më e madhe e studentëve (32%) të cilët deklarojnë se mësimdhënësit përdorin power-point për prezantim janë studentët e programit studimor Psikologji.

Realizimi ligjëratave

Studentët kanë vlerësuar realizimin e orës në lëndët e caktuara nëpërmjet shtatë pyetjeve. Në kuadër të Fakultetit Filozofik, studentët kanë vlerësuar pozitivisht realizimin e orës më të gjitha pyetjet. Edhe atë vlerësim më pozitiv kanë dhënë për sigurinë, bindshmërinë dhe qartësinë e mësimdhënësve gjatë ligjërimit (M= 4.66; M=4.50; M=4.50). Që të tre karakteristikat e mësimdhënësve janë vlerësuar si pozitive në të gjitha programet studimore të Fakultetit Filozofik. Studentët e programit studimor Histori dukurinë mësimdhënësi lexoi tërësisht materialin për prezantim pa shtuar asgjë e kanë vlerësuar negativisht me (M=3.25).

Vlerësimi sipas programeve studimore për indikatorët e vlerësimit të ligjëratave nga studentët është paraqitur në tabelen nr. 1.

Tabela 15. Mesataret e indikatorëve të realizimit të ligjëratave

| | Tema përputhshmëri me ligjëratat | Ligjërata të qarta | Ligjërues i sigurt | Ligjërues bindës |
|-------------------|-----------------------------------------|---------------------------|---------------------------|-------------------------|
| | Mesatarja (N) | Mesatarja (N) | Mesatarja (N) | Mesatarja (N) |
| Histori | 4.31 (87) | 4.47(87) | 4.66 (87) | 4.54 (87) |
| Sociologji | 4.71 (63) | 4.35 (63) | 4.57 (63) | 4.33 (63) |
| Psikologji | 4.64 (230) | 4.55 (230) | 4.68 (230) | 4.52 (230) |

Përmbajtja e ligjërimit/ prezantimit është vlerësuar nëpërmjet 14 pohimeve. Studentët janë përgjigjur me pesë opsione të mundshme, prej aspak nuk pajtohem (1) deri plotësisht pajtohem (5). Studentët kanë deklaruar se materiali i prezantuar gjatë ligjërimit ka qenë në përputhshmëri me temën e prezantuar në fillim të orës (M=4.57), mësimdhënësit pyesin për paqartësi (M=4.57) dhe se studentët e kanë pasur të qartë në çka duhet të fokusohen për të përgatitur temën konkrete (M=4.33). Sipas programeve studimore, studentët e programit studimor Histori dhe Sociologji vlerësojnë se mungon lidhshmëria e përmbajtjeve të prezantuara me përmbajtje të lëndëve (M=2.91; M=2.63) megjithatë në programin studimor Psikologji përveç kësaj dukurie theksojnë se nuk janë të orientuar mjaftueshëm për burime shtesë që do ju shërbenin për zgjerim të informatave (M=2.97). Studentët e programit studimor të Historisë vlerësojnë se mësimdhënësit bëjnë lidhshmërinë e temës së ligjëruar me temat paraprake të të njëjtës lëndë (M=3.53), (Tab. 16).

Tabela 16. Mesataret e indikatorëve për mbajtje s së ligjëratave

| | Orientim në pikat kyçe të temës | Lidhshmëri me tema paraprake | Ilustrim me shembuj i përmbajtjes | Lidhshmëri për përdorim të njohurive në praktikë | Motivim për pjesëmarrje aktive në ligjëratë |
|-------------------|----------------------------------------|-------------------------------------|------------------------------------------|---------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|
| | Mesatarja (N) | Mesatarja (N) | Mesatarja (N) | Mesatarja (N) | Mesatarja (N) |
| Psikologji | 4.19(230) | 3.57 (230) | 4.19 (230) | 3.60 (230) | 3.81 (230) |
| Histori | 3.95(87) | 3.53 (87) | 3.92 (87) | 3.55 (87) | 4.16 (87) |
| Sociologji | 3.93 (63) | 3.83 (63) | 3.81 (63) | 3.29 (63) | 3.70 (63) |

Menaxhimi i orës është vlerësuar nëpërmjet shtatë pohimeve. Përgjigjet e mundshme në të gjitha pohimet kanë lëvizur prej opsionit aspak nuk pajtohem (1) deri plotësisht pajtohem (5). Studentët në nivel të fakultetit japin vlerësime pozitive në pyetjet duke veçuar se nuk ka pasur zhurmë gjatë ligjëratës (M=1.30), kanë qenë të koncentruar në ligjëratë (M=4.11). Në lidhje me menaxhimin e orës gjatë ligjëratës, mësimdhënësi në mënyrë aktive është i orientuar nga studentët (M=3.90) janë dukuri për të cilën ka më tepër hapësirë për përmirësim.

Interaksionin joverbal të mësimdhënësve studentët e kanë vlerësuar nëpërmjet dhjetë pohimeve, gjithashtu me pesë opsione të mundshme për përgjigje edhe atë prej aspak nuk pajtohem (1) deri plotësisht pajtohem (5). Në tërësi studentët vlerësojnë pozitivisht interaksionin e mësimdhënësve ndaj tyre gjatë realizimit të ligjëratës. Kontakti joverbal me të gjithë studentët si vëzhgimi balancuar ndaj gjithë studentëve (M=4.36). Megjithatë, në përgjithësi studentët e Fakultetit Filozofik vlerësojnë se janë të kënaqur me mënyrën e organizimit të ligjëratave (M=4.21). Vlerësimi sipas programeve studimore për një pjesë të indikatorëve të menaxhimit të orës dhe interaksionit joverbal janë të paraqitura në tabelën nr. 17.

Tabela 17. Mesataret e indikatorëve të përmbajtjes së menaxhimit të orës nga mësimdhënësi

| | Dëgjoj në mënyrë aktive komentet e studentëve | Stimuloi për pjesëmarrje aktive në ligjëratë | Ishte i paanshëm gjatë diskutimit të studentëve | Mbaj koncentrimin e studentëve | Vëzhgimi i balancuar ndaj gjithë studentëve | Të kënaqur nga realizimi i orës |
|-------------------|------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------|--------------------------------------------------------|---------------------------------------|----------------------------------------------------|----------------------------------------|
| | Mesatarja (N) | Mesatarja (N) | Mesatarja (N) | Mesatarja (N) | Mesatarja (N) | Mesatarja (N) |
| Psikologji | 3.90 (230) | 3.29 (230) | 3.74 (230) | 4.10 (230) | 4.39 (230) | 4.18 (230) |
| Histori | 4.24 (87) | 3.80 (87) | 4.21 (87) | 4.14 (87) | 4.33 (87) | 4.29 (87) |
| Sociologji | 3.45 (63) | 3.34 (63) | 3.94 (63) | 4.10 (63) | 4.29 (63) | 4.22 (63) |

8. VEPRIMTARIA SHKENCORE DHE HULUMTUESE

Stafi akademik i Fakultetit Filozofik është pjesëmarrës nëpër konferenca, simpoziume, projekte, publikime, monografi dhe shkrime nëpër gazeta ditore të shtypura dhe atyre online, si brenda vendit ashtu edhe jashtë tij.

Gjatë viteve akademike 2016/2017, 2017/2018 dhe 2018/2019, në bazë të të dhënave të publikuara në webfaqen e Universitetit të Tetovës, mësimitdhënësit dhe bashkëpunëtorët në marrëdhënie të rregullt pune në Fakultetin Filozofik kanë botuar 30 libra, 80 punime shkencore dhe kanë marrë pjesë në 100 konferenca, simpoziume dhe tubime shkencore.

Duke i krahasuar këto të dhëna me biografitë dhe bibliografitë e mësimitdhënësve të Fakultetit Filozofik mund të konstatojmë se shumica prej tyre nuk i kanë përditësuar veprimtaritë e tyre kërkimore dhe hulumtuese.

Nga 80 punimet e publikuara në webfaqe, 23 apo 28,75% prej tyre janë botuar në revista shkencore jashtë shtetit. Nga numri i përgjithshëm i punimeve të publikuara më se shumti kanë publikuar mësimitdhënësit e historisë, gjithsej 30 punime apo 37,5%, kurse në revistat shkencore mësimitdhënësit e psikologjisë, 15 nga gjithsej 23 apo rreth 65%.

Mësimitdhënësit dhe bashkëpunëtorët në marrëdhënie të rregullt pune në Fakultetin Filozofik gjatë viteve akademike 2016/2017, 2017/2018 dhe 2018/2019 kanë marrë pjesë në 100 konferenca, simpoziume dhe tubime shkencore, gjysma prej të cilave jashtë vendit.

Dominojnë pjesëmarrjet në konferencat e organizuara nga Fakulteti Filozofik (Konferenca IV, V dhe VI) dhe konferencat e organizuara nga Universiteti i Tetovës (Seminari Ndërkombëtar i Albanologjisë, konferencat vjetore të fakulteteve, etj). Numrin më të madh të

konferencave jashtë vendit e përbejnë organizimet shkencore në Prishtinë dhe Tiranë. Numri më i madh i pjesëmarrësve është nga mësimdhënësit e historisë të ndjekur nga mësimdhënësit e psikologjisë.

Nga 30 librat e botuar 19 janë në gjuhën shqipe, 7 në gjuhën maqedonase kurse 4 janë në gjuhën arabe. Mësimdhënësit e historisë dhe psikologjisë kanë botuar më se shumti. Vetëm 4 nga këto libra janë botime të Universitetit të Tetovës dhe të njëtat shërbejnë si tekste universitare.

Në fund, ritheksojmë se shumica e mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve nuk i kanë përditësuar të dhënat dhe për rrjedhojë nuk kemi një pasqyrë të saktë për veprimtarinë e tyre kërkimore dhe hulumtuese gjatë këtyre tri viteve.

Nga viti akademik 2013/2014, Fakulteti Filozofik organizon Konferencë ndërkombëtare me një temë bosht dhe nëntema nga të gjitha programet studimore.

Në vitin akademik 2016/2017, me datë 27-28 tetor u mbajt Konferenca e 4-të Ndërkombëtare e Fakultetit Filozofik në bashkëpunim me Fakultetin e Edukimit të Universitetit “Kadri Zeka”- Gjilan. Temë boshte e Konferencës ishte “*Education in societies with cultural diversity/ Arsimi dhe edukimi në shoqëritë me diversitet kulturor*”.

Në vitin akademik 2017/2018, me datë 27-28 tetor u mbajt Konferenca e 5-të Ndërkombëtare e Fakultetit Filozofik në bashkëpunim me Forumin ZFD- Shkup. Temë boshte e Konferencës ishte “*Meeting point and cultural divergences in the Balkans/ Pikëtakimet dhe divergjencat kulturore në Ballkan*”.

Në vitin akademik 2017/2018, me datë 22 dhjetor, Fakulteti Filozofik organizoi Simpoziumin shkencor, me temë: “*1968-ta, sfidë e identitetit kombëtar të shqiptarëve në Maqedoni*”.

Nga viti 2014 në kuadër të Fakultetit Filozofik botohet Revista Shkencore Ndërkombëtare “*Philosophica*”. Gjatë viteve akademike 2016/17, 2017/18, 2018/19, janë botuar tre vëllime dhe gjashtë numra, dy numrat e fundit (numri 9 dhe 10) janë në gjuhën angleze dhe lexuesit kanë qasje online. Revista shkencore ndërkombëtare “*Philosophica*” është indeksuar në Google Scholar, IndexCopernicus International dhe CEEOL, kurse është në fazë indeksimi në EBSCO.

9. HAPËSIRAT DHE RESURSET MATERIALE

Fakulteti Filozofik ka në dispozicion salla mësimore, amfiteatër, kabinete, leximore dhe bibliotekë. Numri i sallave mësimore në total është 8, amfiteatro 2, 1 bibliotekë, 1 leximore, ndërsa kabinete gjithsej 18 në numër. Fakulteti Filozofik përmes bibliotekës së tij, e cila është e përbashkët me Fakultetin Pedagogjik dhe Fakultetin Filologjik, u ofron studentëve dhe stafit akademik mbi 2000 tituj librash, e cila vazhdimisht pasurohet edhe me tituj të rinj librash.

Tabela 18. Hapësirat në kuadër të Fakultetit filozofik

| | Hapësira të Fakultetit Filozofik | Numri | m² |
|-----------------|---------------------------------------------------|--------------|------------------------------|
| 1 | Salla mësimore | 8 | 478.01 m ² |
| 2 | Amfiteatër | 2 | 346.84 m ² |
| 3 | Kabinete | 18 | 342.87 m ² |
| 4 | Zyrë administrative në Dekanat | 4 | 60.29 m ² |
| 5 | Zyra të shërbimit administrativ | 3 | 152.87 m ² |
| 6 | Bibliotekë | 1 | 41.79 m ² |
| 7 | Leximore | 1 | 41.15 m ² |
| 8 | Korridore | 2 | 465.50 m ² |
| Gjithsej | | 27 | 1929,32 m² |
| | Pajisje të stafit mësimor të Fakultetit Filozofik | Numri | |
| 1 | Kompjuterë për stafin mësimor | 45 | |
| 2 | Printerë | 22 | |
| 3 | Video projektorë | 10 | |
| Gjithsej | | 77 | |
| | Pajisje të administratës | | |
| 1 | Kompjuterë | 11 | |
| 2 | Printerë | 7 | |
| Gjithsej | | 18 | |

10. SWOT ANALIZA

SWOT analiza si një model themelor i planifikimit strategjik paraqet një kornizë të identifikimit dhe analizës së faktorëve të brendshëm (fuqive dhe dobësive) dhe faktorëve të jashtëm (mundësive dhe kërcënimeve) që ndikojnë në funksionimin e suksesshëm të një institucioni. Identifikimi i komponentëve të jashtëm dhe të brendshëm të SWOT analizës ka një rëndësi të veçantë për mbarëvajtjen e përgjithshme të procesit mësimor-shkencor dhe sukseseve që planifikohen të arrihen në të ardhmen.

Në vazhdim në kuadër të SWOT analizës në Fakultetin Filozofik janë paraqitur faktorët e jashtëm dhe të brendshëm që ndikojnë në mbarëvajtjen e procesit mësimor-shkencor.

Në tabelën më poshtë në kuadër të SWOT analizës, kemi paraqitur „*anët e forta*“ dhe të „*anët e dobëta*“ të ambientit të brendshëm të Fakultetit Filozofik, në të cilat mund të ndikohet dhe veprohet nga vetë institucioni si dhe faktorët e jashtëm potencial të cilët mund të ndikojnë në punën dhe veprimtarinë e Fakultetit Filozofik.

Tabela 19. Swot analiza në kuadër të Fakultetit Filozofik

| Strengths: Fuqitë | Opportunities: Mundësitë |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <ul style="list-style-type: none"> • Ofrim i programeve cilësore të arsimit të lartë dhe shkencës; • Kërkime shkencore në funksion të ngritjes së cilësisë së procesit mësimor-shkencor; • Përmirësim i mësimdhënies përmes përdorimit të metodologjive të reja; • Kultivimi i një mjedisi të hapur ku mundësohet të menduarit kritik dhe kreativ; • Kompatibilitet i programeve studimore me programet e Universiteteve me renome botërore; • Ofrim i programeve të reja studimore në përputhshmëri me kërkesat e tregut të punës; • Infrastrukturë e përshtatshme dhe klimë pozitive dhe kooperuese; | <ul style="list-style-type: none"> • Rritje e rezultateve kërkimore – shkencore të stafit akademik në revista konkurruese të pranuara ndërkombëtarisht; • Bashkëpunimi me bizneset dhe grupe të tjera të interesit; • Rritja e bashkëpunimit në nivel vendor dhe ndërkombëtar me sektorin privat dhe grupe tjera të interesit; • Realizim i metodave të reja të realizimit të mësimit (mësim nga largësia); • Interesimi i lartë i studentëve shtetas të huaj për studime në magjistraturë dhe doktoraturë; • Hapja e programeve të reja studimore, duke përfshirë edhe studimet master dhe të doktoraturës; • Krijimi i një fondi të bursave për |

| | |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <ul style="list-style-type: none"> • Programe kualitative akademike dhe shërbime studentore kualitative; • Avancim i vazhdueshëm i stafit akademik; • Komunikim efektiv pedagog-student; • Transparencë dhe objektivitet në kontrollin e dijeve. • Pjesëmarrja e studentëve dhe mësimdhënësve në programet <i>Erasmus</i> dhe <i>Mevlana</i>. • Efikasiteti i menaxhmentit të Fakultetit Filozofik dhe shërbimit studentor; | <p>hulumtime shkencore afatshkurtër jashtë vendit;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Botimi i revistave shkencore; • Rritja e numrit të pajisjeve teknologjike (kompjuterë, printerë dhe projektorë) |
| <p>Weaknesses: Dobësitë</p> | <p>Threats: Kërcënimet</p> |
| <ul style="list-style-type: none"> • Mungesë e kualifikimit dhe trajnimit të vazhdueshëm të stafit akademik; • Mungesë e rrjetit Alumni për ndjekjen e zhvillimit profesional të studentëve të diplomuar; • Shfrytëzim i dispozitave ligjore dhe institucionale për zgjerim të bashkëpunimit me sektorin privat dhe institucionet shtetërore; • Mungesa e mjeteve financiare për avancimin e projekteve mësimore-shkencore; • Interesim jo i mjaftueshëm nga ana e sektorit privat dhe institucioneve shtetërore për shfrytëzimin e potencialit intelektual; | <ul style="list-style-type: none"> • Ndryshime të shpeshta të ligjeve dhe strategjive për punësimin e studentëve nga faktorë të jashtëm; • Shkallë e lartë e migracionit dhe gjendja e vështirë ekonomike në shoqëri ka ndikuar në uljen e numrit të studentëve; • Disproporcioni i madh i numrit të studentëve të ciklit të parë të disa programe studimore; • Numri i pamjaftueshëm i sallave ku zhvillohet procesi mësimor; • Mungesa e mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve në marrëdhënie të rregullt pune në programin studimor: Filologji orientale; • Mungesa e aktiviteteve dhe punës praktike jashtë Universitetit; • Disproporcioni i madh midis bashkëpunëtorëve me marrëdhënie pune të rregullt dhe me kontratë pune; • Disproporcioni i madh i numrit të studentëve të ciklit të parë të disa programe studimore; • Mosplotësimi/azhurimi i veprimtarisë shkencore nga ana e stafit në web faqen e universitetit. |

11. KONKLUDIMI

Kuadri arsimor dhe administrativ si dhe studentët e Fakultetit Filozofik janë të angazhuar dhe janë zotuar për realizimin e suksesshëm të qëllimeve të këtij fakulteti. Raporti i evaluimit përmes analizave dhe fakteve të paraqitura pasqyron gjendjen reale të fakultetit dhe programeve studimore duke përfshirë të gjitha aspektet e funksionimit të tyre, avancimin dhe të arriturat si dhe anët e forta por edhe të dobëta për të cilat do të ndërmerren masa për tejkalimin e tyre. Në këtë mënyrë do të kontribuohet në realizimin e plotë dhe cilësor të procesit mësimor-shkencor në përgjithësi. Programet studimore në kuadër të këtij fakulteti në vazhdimësi zhvillohen dhe avancohen që të jenë në hap me kërkesat dhe zhvillimet e reja në tregun e punës. Kuadri mësimor i plotëson të gjitha parakushtet në raport me profesionalizmin e tyre në realizimin e procesit mësimor-shkencor. Udhëheqësia e këtij fakulteti në mënyrë permanente ndjek të gjitha zhvillimet dhe inovacionet në arsimin e lartë dhe përkushtohet në etablimin e standardeve të larta për krijimin e një modeli për zhvillim të qëndrueshëm që do të mundësojë arsim cilësor për studentët e tij si dhe një mjedis produktiv dhe motivues për të punësuarit. Si tendencë kryesore e tij në të ardhmen ngel përkushtimi i tij që studentëve t’ju mundësojë një bazë solide të njohurive, shkathtësive dhe shprehive të punës përmes së cilave do të arrijnë jo vetëm zhvillimin dhe avancimin e tyre profesional por edhe avancimin e shoqërisë në të cilën jetojnë.

Komisioni për vetevaluim i Fakultetin Filozofik, në përbërje:

1. Doc.dr. Zejni Mazllami- kryetar,
2. Prof.dr. Hana Saliu- anëtar,
3. Prof.dr. Isak Sherifi- anëtar,
4. Doc.dr. Hiriet Ziberi- anëtar,
5. Doc.dr. Drita Memeti- anëtar,
6. Arnisa Shefiti- anëtar nga radhët e studentëve
7. Xhenisa Habibi- anëtar nga radhët e studentëve

Tetovë, 31.03.2021